



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

N~~D~~-22757 prot.
2

Tiranë, më 19/10/2021

Lënda: Kthim përgjigje

QENDRËS "RES PUBLICA"
Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. Q-22757, datë 11.10.2021 dhe ka kaluar për shqyrtim te Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, e cila nëpërmjet Drejtorisë së Arkivit Qëndror dhe Protokollit ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. Q-22757/1, datë 15.10.2021 si vijon:

"Në përgjigje të kërkesës suaj, ku kërkonti t'ju vendoset në dispozicion një kopje e njehsuar me origjinalin e Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë me nr. prot. 11408/1, datë 25.03.2020 "Për krijimin e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe për zgjedhjen e subjekteve përfituese nga programi grandit të rindërtimit".

Ju bëjmë me dije se në zbatim të ligjit nr. 9154 "Për Arkivat", datë 06.11.2003, Drejtoria e Arkivit Qëndror dhe Protokollit, po ju vendos në dispozicion dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj, të njehsuar me origjinalin".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Blerita Goxha



URDHËR
Nr. 11408/1, datë 25.3.2020

**PËR
KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR VLERËSIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E
SUBJEKTEVE PËRFITUESE NGA PROGRAMI I GRANDIT TË RINDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, nenit 29, pika 1, nenit 64, shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", pikave 16, 17 të vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programet e procesit të rindërtimit", pikave 21, 22 të vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i grandeve të rindërtimit dhe projektet model", si dhe në vijim të memos me nr. 11408, datë 25.03.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale,

URDHËROJ:

1. Krijimin e komisionit të posaçëm, për vlerësimin e kërkesave dhe përzgjedhjen e subjekteve që përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit në Bashkinë e Tiranës.
2. Komisioni, në cilësinë e kryetarit drejtohet nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, dhe ka në përbërje në cilësinë e anëtarëve përfaqësues si më poshtë:
 - Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile;
 - Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
 - Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, të Aseteve dhe Licencimit;
 - Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar.
3. Komisioni i Posaçëm i krijuar sipas këtij urdhri të përmbushë detyrat e përcaktuara në vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, vendimin nr. 5, datë 6.1.2020 të Këshillit të Ministrave, si dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet sipas legjislationit në fuqi.
4. Komisioni i posaçëm gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij asistohet nga sekretariati teknik, i cili si rregull ka në përbërje përfaqësues të drejtorive të cituara në pikën 2 të këtij urdhri. Sekretariati përveç detyra të ngarkuara nga komisioni posaçëm, është përgjegjës për:
 - a. Kontrollonin e dosjeve të çdo aplikanti sipas dokumentacionit që vërteton deklaratimet e bëra në momentin e aplikimit.

- b. Mbledhjen dhe mbledhjen e dokumentacionit të kërkuar për çdo aplikant, i cili ka depozituar
- d. Lirimin e pëlqimit për këtë qëllim.
- c. Dhënien e mendimit kur i kërkohej nga komisioni, mendim i cili pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes;
- d. Mban, harton dhe nënshkrimin e procesverbalit të mbledhjes;
- e. Zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit;
- f. Ruan konfidencialitetin.
5. Drejtoritë që përfaqësojnë komision të caktojnë personat që do të jenë anëtar, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe ti dërgojnë nëpërmjet komunikimit elektronik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale.
6. Njësitë administrative dhe lagjet të marrin masat për ngritjen e grupeve të punës që do të asistojnë dhe ndjekin fazën e dytë të këtij procesi, në mbështetje të veprimtarisë së komisionit të posaçëm të ngritur sipas këtij urdhri.
7. Subjektet jo fituese mund të paraqesin ankesat e tyre në Bashkinë Tiranë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, pranë zyrës së nënkryetares, zonja Anisa Ruseti.
8. Ngarkohen komisioni i posaçëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion VELIAJ

